



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.23, datë 21/07/2023

PËR

**MIRATIMIN E “KËRKESË PËR KRYERJE SHPIMI  
NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”, Z. LULËZIM  
PEPA**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje “Kërkesë për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi)” për qëllime të ndryshme, të z. Lulëzim Pepa, me vendndodhje, Astir, Bashkia Tiranë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin

- X=481561.8
- Y=4577229.8
- Z=84 m.m.n.d

Prurja e kërkuar:  $Q = 0.2$  l/sek.

- Thellësia e parashikuar = 150 m
- Diametri 1 (mm) 350 - Thellësia nga 0.00 m në 7.0 m
- Diametri 2 (mm) 250 - Thellësia nga 7.00 m në 150 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU ISHËM**

**EMILJAN JANI**

